



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	20 10 2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHCK	6352/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.799/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.799/2022 të datës 14.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike-administrative "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 20.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.799/2022 të datës 14.09.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me nr.4798/2013 të datës 19.12.2013 në pozitën "Zyrtar Financiar" në Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve (në tutje AKKV) Shota në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 14.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5390/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor në kuadër të AKKV Shota të datës 16.08.2022 dhe kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të formuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit të datës 21.07.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullos Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ndërsa kjo e fundit më datë 29.09.2022 ka përcjell në Këshill përgjigjen me numër protokolli 5749/2022 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.09.2022 me Nr.protokolli 5390/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit Disiplinor në kuadër të AKKV "Shota" me nr. protokolli 3677/2022 i datës 19.08.2022; Akt Emërim i A.M. me nr.4798/2013 i datës 19.12.2013; Shkresë me nr.8 lidhur rezultat pozitiv me COVID-19 e A.M.; Udhëzim për konsultim nga QKMF për A.M. 05.07.2022; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarit publik A.M. Zyrtar Financiar në institucionin e shërbimit publik Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Shota me nr. protokolli 3145/2022 i datës 20.07.2022; E-mail nga V.P për A.M. i datës 27.07.2022; Njoftim për Inicimin e Procedurës Disiplinore me nr. protokolli 3220/2022 i datës 22.07.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 19.09.2022; Përgjigje në ankesë me nr. protokolli 5749/2022 e datës 29.09.2022; E-mail nga D.B. për V.SH. etj. i datës 28.07.2022; E-mail nga V.SH. për SH.I. etj. i datës 27.07.2022; E-mail nga D.B. për A.M. i datës 14.06.2022; E-mail nga D.B. për A.M. i datës 28.06.2022; E-mail nga D.B. për SH.I. i datës 30.06.2022; E-mail nga SH.I. për D.B. i datës 29.06.2022; E-mail nga D.B. për A.M. i datës 28.06.2022; Vendim i Komisionit Disiplinor në kuadër të AKKKV Shota me nr.protokolli 2876/2022 i datës 30.06.2022; E-mail nga L.B. për C.Z. i datës 11.10.2022 i protokolluar në KPMSCHK me datë 12.10.2022 me nr. protokolli 6116/2022; E-mail nga T.B. për L.B. i datës 10.10.2022; E-mail nga A.H. për T.B. i datës 19.01.2022; E-mail nga SH.L. për A.H. i datës 12.01.2022; E-mail nga T.B. për SH.L. i datës 12.01.2022; E-mail nga C.Z. për T.B. i datës 06.10.2022; E-mail nga L.B. për C.Z. i datës 19.10.2022; Vendim me nr. protokolli 3203/2022 i datës 21.07.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën "Zyrtar Financiar" në Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve-Shota sipas Akt Emërimit me nr.4798/2013 të datës 19.12.2013 në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndaj ankuesit janë ndërmarrë veprime disiplinore nga Komisioni Disiplinor në kuadër të AKKV-Shota me Vendimin Nr.01/2022 të datës 27.06.2022 dhe vendimin Nr.01/2022 të datës 16.08.2022, i njëjti përmes ankesës për shkak të aplikimit të gabueshëm dhe të padrejtë të dispozitave ligjore, shkeljes thelbësore të së drejtës marrëdhënies së punës dhe konstatimit të paqëndrueshëm të gjendjes faktike i është drejtuar me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar ankesën e ankuesit Agim Maxhuni, me datën 06.10.2022 përmes e-mailit zyrtar Këshilli ka kërkuar informata zyrtare prej Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik respektivisht statusin e ankuesit ndërsa në përgjigjen zyrtare të

datës 11.10.2022 përmes e-mailit zyrtar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit adresuar për Këshillin e cila shkresë është protokolluar me numër protokoll 6116/2022 datë 12.10.2022, kjo e fundit ka deklaruar se: *Bashkangjitur gjeni konfirmimin nga DMZP për statusin e nëpunësve të shërbimit Publik në Institucionet e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore, konkretisht statusi për* Ndërsa sipas E-mailit zyrtar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik te datës 19.01.2022 pozita "Zyrtar Financiar" ka statusin e nëpunësit të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me kompetencën lëndore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur për këtë çështje, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 2 paragrafit 4, ku përcaktohet se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"* dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pozita "Zyrtar Financiar" në Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.799/2022, datë 20.10.2022.

Çlirim Zeka



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.